

#2160

Thirrja për në shërbesë

2 e Korintasve 4:1–7

Letra e Dytë Drejtuar Korintasve, kapitulli 4. Ajo që dua të bëj tani, është që thjesht t'ju kujtoj disa prej të vërtetave thelbësore që Pali i pohon teksa shkruan këtë letër, të cilën ne e njohim si 2 e Korintasve. Kjo është letra me natyrën më të thellë biografike nga të gjitha letrat e Palit. Mendoj se ai na e zbulon më tepër zemrën e tij në Letrën e Dytë Drejtuar Korintasve, sesa në të gjitha letrat e tjera, duke përfshirë këtu edhe 1 e Thesalonikasve. Kjo letër është jashtëzakonisht e dobishme për ne si pastorë, për faktin se këtu zbulohen tensionet që krijohen në shërbesë, të cilat u shkaktuan nga kritikët e tij. Kur dallojmë se gjërat nuk na shkojnë vaj, jo vetëm që i kujtojmë vetes se Jezusi tha që nuk duhet të presim që *të jetë* kështu, por kur shohim jetët e apostujve, zbulojmë që edhe ata u përballën me sfida të caktuara.

Në fakt, Letra e Dytë e Palit Drejtuar Korintasve është e jashtëzakonshme për mënyrën se si i demonstroi qoftë privilegjet, qoftë trysnitë e punës pastorale. Secili prej nesh është i vetëdijshëm në njëfarë mase se cilat janë këto trysni dhe këto privilegje. Meqë ra fjala, unë mendoj se kjo është një nga letrat më të shpërfillura të Palit, kur bëhet fjalë për mësimdhënien nëpër bashkësitë lokale. Ndoshta ju tashmë e keni dhënë mësim Letrën e Dytë të Korintasve; unë nuk e kam bërë kurrë—edhe pse kam qenë i përfshirë në shërbesë për njëzet e pesë vjet, dhe nuk jam i sigurt se jam shumë ndryshe nga të tjerët.

Tani që ju kam paraqitur këtë reflektim në lidhje me natyrën e gjërave, nuk dua të kaloj më shumë kohë në paraqitjen e kontekstit. Në fakt, dua që t'i shohim bashkë këto deklaratat të mëdha që bën Pali në lidhje me shërbesën e ungjillit, në të cilën është thirrur ai dhe kolegët e tij.

“Këtë shërbesë e kemi përmes mëshirës së Perëndisë”

Pali thotë: “Perëndia na e dha këtë shërbesë nëpërmjet mëshirës...” (Bibla “Së Bashku”, 2020). Ne kemi marrë hirin e Perëndisë, i cili na i fal mëkatet tona. Ne kemi marrë mëshirën e tij, e cila na ngushëllon. Hiri i tij është dashuria që ka ai për fajtorët; mëshira e tij është një shprehje e dashurisë që ka ai për ata që janë të pikëlluar. Ndonjëherë ndodh që, kur bëhemi të vetëdijshëm për mëshirën e Perëndisë në pikëllimin tonë, ne tërhiqemi te hiri i Perëndisë, i cili pastaj na trajton në fajin tonë. Duhet t’i kujtojmë vetes sot—tekta arrijmë te kjo frazë, e cila është themeli i të qenët në gjendje të themi atë që thotë ai në deklaratën e parë. Dua të vini re se ka më tepër mëshirë në Zotin Jezus nga sa ka mëkat në ne. Ka më tepër mëshirë në Zotin Jezus, sesa ka mëkat në ne.

Pali duhet të ketë pasur mundësi të reflektonte vazhdimisht për këtë gjë, ndërsa mendonte se si kishte qenë jeta e tij para se të ishte kapur nga Jezusi në rrugën për në Damask—gjithë ato kujtime, të cilat ai i mbante në zemër për skenën e vrasjes me gurë të Stefanit, si edhe shumë rrethana të tjera të trishtueshme dhe prekëse, të cilat lidheshin drejtpërdrejt me përndjekjen e tij ndaj kishës së Perëndisë. Ju mund ta përfytyroni ndjesinë e pasionit që vërshonte brenda tij ndërsa ai i shkroi apo i diktoi këto fjalë: “Perëndia na e dha këtë shërbesë nëpërmjet mëshirës...” (Bibla “Së Bashku”, 2020). Kush do ta kishte vallë këtë shërbesë nga të gjithë njerëzit e mundshëm? Pali do të kishte thënë—Sauli i Tarsit do të kishte thënë—“Sigurisht, jo unë.”

“Nuk ligështohemi”

Ka disa rrjedhoja që burojnë prej faktit që shërbesa na është dhënë nëpërmjet mëshirës së Perëndisë. E para: “Nuk ligështohemi.” Nuk na lëshon zemra. Kjo është gjëja e vetme të cilën ai e thotë dy herë në këtë kapitull. Do të vini re që ai e thotë sërish në vargun 16: “Prandaj nuk ligështohemi.” Është vërtet interesante të studiojmë se sa herë i thotë Pali gjëra të tilla në jetën e

tij. Për shembull, ai shpall se “nuk ka turp”.¹ Sigurisht që komentuesit thonë se ky është thjesht një shembull se si ai thotë diçka pozitive në formë negative, se nuk ekziston mundësia që Pali të ketë ndonjëherë turp—dhe se, në fakt, ajo që ai po thotë është: “Unë jam vërtet shumë agresiv dhe i guximshëm në marrëdhënie...” Këtë ai e shpreh në një formë negative.

Nuk mendoj se kemi nevojë që ta themi këtë. Mendoj se Pali ishte një burrë normal. Sigurisht që ai ishte i vajosur nga Fryma e Perëndisë. Si apostull, ai ishte pjesë e një grupi të papërsëritshëm individësh në themelimin e kishës. Por jam i sigurt që ai e dinte se çfarë do të thoshte që ta shihte kontekstin e Korintasve, apo të ecte nëpër Athinë dhe të përjetonte një ndjesi turpi, një ndjesi dëshpërimi dhe një ndjesi shkurajimi. Në fund të fundit, çfarë do t’u thoshte ai gjithë atyre intelektualëve mendjendritur? Ai do t’u fliste për “Jezu Krishtin, dhe atë të kryqëzuar”.²

Tani ai thotë: “Nuk ligështohemi.” Është vërtet tundim i madh që të ligështohesh. “Nuk ligështohemi.” Është prirje normale që të të lëshojë zemra. Sigurisht që kishte shumë gjëra në jetën e tij të cilat do ta shkurajonin. Nëse ktheheni te kapitulli i parë, në vargun 8 ai thotë: “Sepse nuk duam, o vëllezër, që të mos dini për shtrëngimin që na ndodhi në Azi, ku u rënduam tepër, përtej fuqive tona, aq sa u dëshpëruam edhe për jetën. Për më tepër ne e kishim në veten tonë vendimin e vdekjes.” Prandaj, kur ai thotë: “Nuk na lëshon zemra”, nuk është duke thënë—kjo është një lloj teologjie e ftohtë. Ai është duke shprehur bindjet e tij. Ai thotë se e gjithë ajo ndjesi e të qenët i mbingarkuar, për të cilën ai flet në vargun 9, ndodhi “që të mos besonim në veten tonë, por në Perëndinë që ringjall të vdekurit”.

¹ Romakëve 1:16.

² 1 e Korintasve 2:2.

Tani, më lejoni që nga situata e Palit të kalojmë në situatën tonë në shërbesë pastorale. Ne nuk jemi duke u përballur me të njëjtat situata që u përball ai në Ikon dhe në Listra. Nuk kemi ecur në të njëjtin shteg si Pali, por duam të jemi në gjendje që të themi si ai: “Nuk na lëshon zemra.” Sigurisht që e dimë se ka një tundim real për t’u ligështuar dhe se ka sfida të caktuara për ne në shërbesën pastorale. Për shembull, ka *pritshmëri të cilat nuk mund t’i përmbushim dot*. Pritshmëri të cilat nuk mund t’i përmbushim dot. Pritshmëri që të tjerët kanë ndaj nesh, ndoshta për shkak të atij burri që jemi duke ndjekur, ndoshta për shkak të rrethanave të veçanta të këtij vendi, dhe tani jemi thirrur aty, dhe kjo bashkësi ka një pritshmëri e cila lidhet drejtpërdrejt me kombinimin e dhuntive të dikujt tjetër. Kjo mund të bëjë që të ligështohemi së tepërmi.

Nuk na lëshon zemra përballë *akuzave të cilat s’mund t’i anashkalojmë dot*. Ka akuza të cilat mund të shmangen; dhe këto janë akuza që ia sjellim vetes. Mirëpo, ka edhe akuza të tjera të cilat nuk mund të shmangen. Sigurisht që Pali e dinte se çfarë do të thoshte që të ishte pre e atyre akuzave. Më parë, ju kam përmendur 1 e Korintasve 4:4, ku ai thotë: “Sa për mua, më intereson fort pak që të gjykohej prej jush... madje as vetveten nuk e gjykoj. Sepse nuk jam i vetëdijshëm për asnjë faj, por për këtë nuk jam justifikuar, por ai që më gjykon është Zoti. Prandaj mos gjykoni asgjë para kohe derisa të vijë Zoti.”³ Në sesionin tonë të parë, përmenda disi me shaka Nehemia 6:8: “Punët nuk janë ashtu si thua ti, por ti i shpik në mendjen tënde.” Sinqerisht, kjo *është* një përgjigje dhe *është* një reagim të cilit mund të kemi nevojë t’i kthehemi me raste, përndryshe, do të zhgënjehemi tmerrësisht.

Pritshmëri të cilat s’mund t’i përmbush dot. Akuza të cilat s’mund t’i shmang dot. *Shpërfillje të cilën s’mund ta mposht dot*. Një shpërfillje të cilën s’mund ta mposht dot. Disa prej jush kanë folur me mua për mënyrën se si besojnë që po bëjnë më të mirën që mundën në

³ 1 e Korintasve 4:3–5.

predikimin e Biblës, e megjithatë, duket sikur ka një lloj shpërfilljeje nga ana e njerëzve. Nuk ka një lloj pranimit si ai për të cilin keni lexuar në biografite të predikuesve të tjerë. Prandaj po vrisni mendjen: Mos vallë problemi qëndron te ju apo mos duhet të hiqni dorë nga metodologjia, apo çfarë mund të bëni? E po, e vetmja gjë që nuk duhet ta bëni, është që të ligëshoheni. Mos u ligështoni!

Nuk na lëshon zemra, pavarësisht pritshmërive që s'mund të përmbushen, akuzave që s'mund të anashkalohen, shpërfilljes që s'mund të mposhtet dot dhe një *verbërie të cilën s'mund ta heqim dot*. Sepse “perëndia i kësaj bote ua verboi mendimet atyre që nuk besojnë, që drita e ungjillit të lavdisë së Krishtit, që është shëmbëllimi i Perëndisë, të mos ndriçojë tek ata”.⁴

Kësaj i shtojmë edhe personalitetet tona, sfidat tona personale, të gjitha mëkatet tona të cilat na qarkojnë aq lehtë, dhe këtë duhet ta marrim e të kapemi fort pas saj. Ndërsa kthehemi dhe mendojmë sërish për sfidat e së dielës që po vjen, le të lutemi: “Zoti Jezus, më bëj që të them sot bashkë me Palin: ‘Nuk na lëshon zemra.’”

“Ne nuk përdorim mashtrim”

Së dyti, “duke mos ecur me dinakëri”. Ne nuk përdorim mashtrim. Ne kemi hequr dorë nga qasja *kruptos*, nga qasja e fshehtë. Ne nuk do të jemi ata që janë *aishunas*, të turpshëm. Siç thotë edhe vargu: “Ne mohuam gjërat e turpshme që bëhen në fshehtësi.” E mbani mend që fjala për “mashtrim” është *panourgia*; kjo është karakteristikë e politikanëve të paskrupull apo e një shitësi dinak të makinave të përdorura. Përkthimi *Philips* e parafrazon kështu: “Ne nuk përdorëm magji, as hile dinake, nuk përdorëm manipulim të pandershëm të Fjalës së Perëndisë.” Vëllezër, këtë duhet të themi edhe ne. Nëse themi se nuk përdorim mashtrim, kjo gjë na sfidon menjëherë, sepse do të ketë shumë gjëra të cilat do të na ligështojnë, për shkak se jetojmë në një kontekst të

⁴ 2 e Korintasve 4:4.

padëmshëm, tolerant dhe të mjegullt nga ana teologjike, në të cilin teologjia është produkt i të mashtruarve dhe mashtruesve. Mbajmë mend që ishte [Charles Gore] ai që tha se një nga sëmundjet më të mëdha të predikimit bashkëkohor në kohën e tij ishte dëshira për të qenë popullor.⁵

Nuk ka pse ta stërgjasim këtë gjë. Ama duam të tregohemi të kujdesshëm, që të mos *jemi* paksa mashtrues në mënyrën se si i themi ose i bëjmë gjërat. Ne nuk përdorim mashtrim, sepse kemi vendosur të heqim dorë nga mënyra se si veprojnë këta mësues të rremë me praktikatat e tyre të fshehta dhe me udhët e tyre të turpshme.

“Nuk shtrembërojmë”

Ne nuk përdorim shtrembërim. Nuk e shtrembërojmë aspak Fjalën e Perëndisë: *dolountes*. Hollimi i Fjalës së Perëndisë. Ne nuk e hollojmë Fjalën e Perëndisë për ta bërë atë më të pëlqyeshme. Ne kemi vendosur që nuk do të bëjmë atë lloj predikimi që gudulis veshët e njerëzve sipas 2 e Timoteut 2.⁶ Nuk do t'i përkëdhelim njerëzit dhe t'i bëjmë të ndihen sikur ne jemi personi më i mrekullueshëm mbi faqen e dheut, sepse na është dhënë privilegji të jemi lajmëtarë. Ne duhet të dëshmojmë për Perëndinë para burrave dhe grave. Prandaj, ne nuk guxojmë të përdorim asnjë formë hollimi apo shtrembërimi të Fjalës së Perëndisë.

E pamë Gjon Pagëzorin në fillim të shërbesës së tij, apo jo? Sigurisht që ai nuk ishte i përfshirë në shtrembërim, apo jo? Ai nuk të linte përshtypjen që po e hollonte mesazhin. Sërish po ju them, provojeni këtë si hyrjen e një mesazhi ungjillëzues: “Mirëmbërëma zonja dhe zotërinj, dhe faleminderit që keni ardhur, ju pjellë nepërkash! Kush ju paralajmëroi që t'i arratiseni gjykimin që po vjen?”⁷ Kjo nuk është një hyrje të cilën do ta quanit “të ndjeshme ndaj kërkuesve”, apo jo?

⁵ Atribuuar Charles Gore-s në James S. Stewart, *Heralds of God* (New York: Charles Scribner's Sons, 1946), 29.

⁶ Shih 2 e Timoteut 4:3.

⁷ Mateu 3:7 (parafrazim). Shih gjithashtu Luka 3:7.

Çfarë mund të themi për rastin kur Pali doli para Feliksit dhe Druzilës te Veprat kapitulli 24? A e keni parë atë skenë? Përfytyrojeni pak situatën. Jeni në Shtëpinë e Bardhë për një ditë. Keni një problem, ju lënë të prisni, dhe presidenti bashkë me zonjën e parë ju ftojnë të takoheni me ta. Ata ishin duke luajtur damë në mbrëmje, kanë qenë duke bërë disa gjëra, dhe tani nuk kanë ç'të bëjnë tjetër, prandaj ulen për të ngrënë darkë dhe njëri i thotë tjetrit: “Pse të mos thërrasim apostullin Pal dhe të dëgjojmë se ç’do të na thotë? Me sa duket, ai është një predikues i mrekullueshëm?”. Dhe kështu e thirrën. E mbani mend se ai ka qenë në pritje që të vijnë juristët e tjerë për ta trajtuar çështjen e tij.

Prandaj shohim Palin te Veprat 24:24. Mund ta përfytyroni Palin që hyn brenda, duke mos qenë ndonjë person tepër tërheqës. Sigurisht që me aq sa dimë ne, ai nuk do të ishte një lojtar shtatlartë në një ekip gjimnazi që luan futboll amerikan. Duket qartë që ai nuk do të kishte qenë një tip i tillë. Ai mund t’i ngjante më tepër aktorit Dustin Hoffman, jo në ditën e tij më të mirë, që çalonte, dhe me më pak flokë se ai. Ja ku hyn Pali. Të ulur në pozitën e pushtetit dhe autoritetit janë Feliksi dhe bashkëshortja e tij, Druzila.

Prandaj, Pali thotë: “Ju faleminderit që më ftuat! Jam i gëzuar që më dhatë mundësinë të flas me ju. Kam një predikim me tri pika, të cilin dua t’jua përcjell, dhe pika e parë është: drejtësia. Dua që t’ju flas për drejtësinë.” Foli për këtë gjë për njëfarë kohe, derisa dalloi pikat e djersës mbi ballin e Feliksit dhe vuri re që Druzila nuk po gjente rehati e ulur në fron. Pastaj tha: “Tani do t’ju flas për pikën time të dytë: vetëkontrolli.” Sigurisht që ata po jetonin në një marrëdhënie kurorëshkeljeje. Feliksi e kishte rrëmbyer këtë grua nga bashkëshorti i saj si rezultat i punës së një magjistari qipriot. Për këtë arsye, Pali thotë: “Faleminderit që më ftuat! Dua që t’ju flas për ligjin moral të Perëndisë dhe për faktin që ju gjendeni në një situatë krejt të tmerrshme para tij, pasi Perëndia na bën thirrje të jemi të drejtë në sytë e tij. Tani më lejoni t’ju flas për vetëkontrollin.

Pika ime e tretë, për të cilën dëshiroj t'ju flas, ka të bëjë me gjykimin me të cilin do të përballeni kur të dilni para Perëndisë.”⁸

Sërisht, ju sugjeroj se kjo nuk është pikërisht mënyra se si fillon duke thënë: “Vras mendjen se me çfarë përballen Feliksi dhe Druzila. Ndoshta duhet t'u flas atyre për stresin. E di çfarë? Në fund të fundit, ata duhet të jenë *tepër* të stresuar. Ndoshta duhet t'u flas atyre për financat; duket se kanë shumë para, dhe nuk jam i sigurt se si po ecën bursa tani. Do t'u flas për perspektivën biblike mbi financat apo diçka të tillë.” Jo, Pali u ngjitet shkallëve dhe thotë: “Ju faleminderit për mundësinë! E para, drejtësia. E dyta, vetëkontrolli. Dhe e treta, gjykimi që po vjen.” Dhe njerëzit thonë: “Nuk më pëlqen t'i dëgjoj ato predikime që flasin për dënimin dhe zjarrin e ferrit.” Kur ishte hera e fundit që dëgjuat një predikim mbi dënimin dhe zjarrin e ferrit? Kur ishte hera e fundit që ju e predikuat një mesazh të tillë? Kur ishte hera e fundit që u treguat mjaft të guximshëm kur dolët para anëtarëve të bashkësisë suaj—të shëndoshë, të dobët, të pasur, me siguri në veten e tyre—dhe t'u thoshit: “Keni një takim me Krishtin e ringjallur, dhe nuk po jetoni në përputhje me ligjin e tij të drejtë; mungesa e vetëkontrollit nga ana juaj është një tregues i faktit që keni *nevojë* për Krishtin!”. Mbani mend këtë, ata janë ulur aty dhe po mendojnë: “Më thuaj gënjeshtër, më thuaj gënjeshtër, më thuaj gënjeshtër të bukura! Më thuaj gënjeshtër!”⁹

Pali thotë: “Jo, ne nuk ligështohemi. Ne nuk përdorim mashtrim. Ne nuk shtrembërojmë.” Ai qëndron në kontrast të hapur me kishën e sotme—një kishë e frikësuar. A do ta sfidojmë errësirën kulturore të kohës sonë? Apo do të përpiqemi të gjejmë një ungjill që reflekton errësirën? A do t'u flasim njerëzve më tepër se si të jenë të përmbushur apo se si të jenë të shenjtë? A do ta trajtojmë atë që Bibla ka për të thënë për mëkatën, apo mos vallë do të përpiqemi vazhdimisht ta

⁸ Shih Veprat 24:25.

⁹ Christine McVie dhe Eddy Quintela, “Little Lies” (1987). Teksti është ndryshuar pak.

zbutim atë me fjalë të tilla si *mangësi*? A do t’u ofrojmë njerëzve rimëkëmbje, që të vazhdojnë të çalojnë gjithë jetën e tyre, si rezultat i teorisë psikologjike që e shpjegon hallin e tyre dhe i ndihmon të ecin përpara, apo do t’u flasim për shpëtimin? Kjo është çështja.

Ne nuk na lëshon zemra. Ne nuk përdorim mashtrim. Ne nuk do të përdorim shtrembërim. Gjuha e terapisë ka zëvendësuar moralin në kulturën tonë—dhe fatkeqësisht, kjo ka ndodhur edhe në shumë nga kishat tona. Një mesazh i holluar i shërben idesë sonë të vetëmjaftueshmërisë, në vend që të jetë një mesazh tepër i fuqishëm, i cili përcjell mjaftueshmërinë unike të Krishtit. Bibla bëhet një manual udhëzimesh hap pas hapi për një jetë të lumtur dhe predikimet bien në nivelin e gjërave të rëndomta, ose ngrihen në nivelin e moralizmit bombastik. Ëshë e mahnitshme se sa shumë predikim moralist që ka në kishat ungjillore, ku njerëzit vijnë dhe, me pak fjalë, u thuhet: “Tani, përpiku të jesh një person më i mirë këtë javë, dhe më lejo të të jap shtatë mënyra se si mund të jesh një person i tillë.” Kështu, njerëzit përcillen dhe kjo është krejtësisht e padobishme. Ata i kanë provuar të shtata mënyrat, edhe pesë ditë të tjera dhe katër mënyra shtesë—dhe kanë zbuluar që moralizmi nuk funksionon! Legalizmi nuk funksionon. Fariseizmi është i kotë.

Çfarë ke nevojë të dish? Nuk jam i sigurt, por ndoshta ishte Calvin-i ai që tha: “E dini çfarë? Unë kam nevojë të di vetëm dy gjëra: që unë jam një mëkatar i madh dhe që Krishti është një Shpëtimtar i madh.”¹⁰ Ne, pra, kemi nevojë ta predikojmë ligjin e Perëndisë, që njerëzit të ballafaqohen me faktin që janë të thyer dhe të shqetësuar, dhe se kanë nevojë të shpëtohen. Ne kemi nevojë t’u themi: “Ju po jetoni në një ndërtesë që ka marrë zjarr.” Kjo gjë është e vështirë këtu ku jetojmë. Njerëzit ngasin makina luksoze dhe vijnë të veshur me rroba dhe kostume të bukura. Këta janë njerëzit më të vështirë për t’u predikuar. Do ta shkëmbeja vendin me shumë prej jush. Mendoni se kjo është fantastike? Ejani dhe provojeni! “Dhe po jua përsëris: Është më lehtë

¹⁰ I atribuohet John Newton-it në John Pollock, *Amazing Grace: John Newton’s Story* (San Francisco: Harper and Row, 1981), 182. Parafrazim.

të kalojë deveja përmes vrimës së gjilpërës, sesa i pasuri të hyjë në mbretërinë e Perëndisë.”¹¹ Pse? Sepse ata janë mësuar të bëhen pjesë e çdo klubi që dëshirojnë duke paguar: “Unë luaj këtu, unë luaj atje, unë stërvitem këtu, unë shkoj atje; ne i bëjmë pushimet atje. Më trego për punën e asaj mbretërisë. Për çfarë ke nevojë? Për çfarë ke nevojë? Do ta bëj, do ta bëj.” Thuajuni: “Kam një lajm për ju: hyni këtu duke u zvarritur me bark.” Ata ju thonë: “Jo, unë nuk zvarritem me bark për askënd.” “Kjo është pikërisht arsyeja pse nuk do të hysh në mbretëri.”

Tani, unë u them njerëzve kështu. Kolegët e mi do të më durojnë. Unë *u them* kështu. Ose jam unë i çmendur, ose është Fjala e Perëndisë. Nuk mund të qëndrojmë në këmbë e të këndojmë,

Nuk kam nevojë për asnjë argument tjetër,

Dhe për asnjë përgjërë.

Mjafton që Jezu Krishti vdiq,

Ai vdiq në vendin tim,¹²

dhe pastaj t’u japim njerëzve broçkulla moraliste se si mund të përmirësohen dhe të jenë në gjendje të takohen me Perëndinë.

“Ne nuk shpallim veten tonë”

Së katërti: “Sepse nuk shpallim veten tonë.” Ne nuk predikojmë veten tonë. Ne jetojmë në një botë plot me personalitete dhe pa heronj, apo jo? Nëse nuk kemi asgjë për të thënë, mendoj se mund të flasim për veten. Deri në një pikë të caktuar, ne si predikues nuk mund ta shmangim dot Palin apo Apolin. Ju vini dhe më kërkoni nëse mund t’ju jap një autograf në libër; e kuptoj si qëndron kjo punë. Por sinqerisht, kjo nuk më krekos! Së pari, nuk mendoj se libri është aq i mirë.

¹¹ Mateu 19:24. Shih gjithashtu Marku 10:25; Luka 18:25.

¹² Eliza E. Hewitt, “My Faith Has Found a Resting Place” (1890).

Djali më tha dje: “Pse nuk shkruan një libër të cilin dikush do të ketë dëshirën ta lexojë një herë?”. Kjo është arsyeja pse Perëndia na jep adoleshentë dhe të rinj; për këtë jam mirënjohës.

Prandaj, deri në një pikë të caktuar, ju nuk mund t’i shpëtoni faktit që mund të jemi inkurajim për njëri-tjetrin, dhe që Perëndia na përdor në një pikë të caktuar në garë për t’i dhënë një nxitje njëri-tjetrit: “Eja, le të vrapojmë; më ndihmon; faleminderit që e bëre; mbaje mend këtë; kjo ishte e rëndësishme për mua.” Mund t’ju tregoj Biblat e mia; ato janë plot me emra njerëzish, të cilëve u kam kërkuar që të më japin autografe. Pse? Sepse ato janë gjëja më madhështore që nga koha kur u shpik buka e prerë në feta? Jo. Thjesht, sepse unë i vlerësoj ata dhe fakti që emrat e tyre janë në kapakun e Biblës time apo në librin tim, më shërben si kujtim për një pikë të rëndësishme gjatë udhëtimit tim. Prandaj këtë e pranojmë. Nuk mund ta shmangim dot punën e Palit/Apolit. Ama *mund* të shmangim *kultivimin* e saj. Mund të shmangim *kultivimin* e saj. Nëse kjo ndodh, duhet që ta trajtojmë atë. Nëse po përpiqemi ta *bëjmë* të ndodhë, kjo është diçka krejt tjetër, e kuptoni?

Shikojini të gjithë ata minifurgona në zonën e Cleveland-it të cilët në pjesën e tyre të pasme kanë ngjitësa për fëmijët e tyre, që thonë: “Këtu është një student i shkëlqyer”, “Këtu është një student i shkëlqyer.” Pse e bëjnë këtë gjë vallë? Asnjë prind nuk do ta vendoste një ngjitës të tillë në makinën e vet para njëzet vjetësh dhe ta ngiste makinën nëpër qytet. Pse? Sepse kjo gjë do të konsiderohej si një tregues krenarie dhe mburrjeje të madhe. Ju nuk mburreni për fëmijët tuaj dhe të vendosni një ngjitës për këtë në makinën tuaj e t’i jepni nëpër qytet, apo jo? E po, tani e bëni. Kjo ndodh sepse, këta fëmijë të dobët dhe të rrënuar në vetëvlerësimin dhe përhumbljen e tyre, kanë nevojë të dinë se sa të mrekullueshëm dhe gjenialë që janë, në mënyrë që të kenë vendin e nderit në restorant, prandaj e kemi të vështirë të dëgjojmë mendimet tona, sepse Penelopa e vogël duhet të bëjë atë që i pëlqen dhe ne duhet të merremi me të—në të vërtetë, duam ta marrim dhe ta

hedhim nga dritarja! Pastaj të hedhim edhe prindërit pas saj! Dhe të themi: “Kur u bënë *këto* gjëra qendra e gjithësisë?”. A nuk e di se çfarë duhet të bësh? Isha në restorantin “Cooker”, në kryqëzimin e rrugëve 480 dhe Rockside, dhe atje ishte një vajzë e vogël, e cila e kishte bërë babanë të derdhte lot në tualet. Ajo e kishte bërë babanë e saj për të qarë! Ajo ende nuk i kishte mbushur tre vjet. Unë e dija përgjigjen—por ai nuk donte ta dëgjonte, dhe as asaj nuk do t’i pëlqente.

Ju pyesni: “A po flasim ende për të njëjtën gjë?”. Nuk e di! Kur na u kthye kjo në një pyetje? E di se çfarë po mendoni; ju po mendoni: “E po, fëmijët e tij janë gdhë vare, dhe ai nuk mori kurrë një nga këta ngjitësat.” E po, ata mund të jenë gdhë, ama unë i mora ngjitësat, dhe i kemi vendosur te dera e frigoriferit... për nja shtatë minuta. Mirëpo, gruan time nuk e ka parë asnjëri nëpër Cleveland bashkë me frigoriferin e saj, që shoqet dhe fqinjët e saj të mund ta kuptojnë se sa të zgjuar që janë fëmijët tanë.

“Ne nuk shpallim veten tonë.” Keni dëgjuar për atë skocezin që po tregonte foto të Malësisë, në Angli; ai tani banon në Angli. Dikush i bëri një pyetje, pasi kishte treguar gjithë ato fotografi të bukura nga Skocia; i tha: “Ju keni jetuar për një kohë të gjatë në Angli. A nuk ndiheni që tani jeni më shumë anglez sesa skocez?” “Oh, jo”, ia ktheu ai, “unë linda skocez, unë jetoj si skocez dhe do të vdes si skocez!” Dikush komentoi: “Ka edhe njerëz që nuk kanë kurrëfarë ambicieje.”

Oscar Wilde-i, kur po vinte nga Franca në Amerikë, e pyetën nëse kishte ndonjë gjë për të deklaruar në doganë, dhe ai u përgjigj: “Asgjë, me përjashtim të gjenisë sime.” Ky është citat. “Çfarë keni për të deklaruar?” “Asgjë, me përjashtim të gjenisë sime.” Le të kthehem aty ku filluam. Nuk mund të them: “Ai është, ai është, ai është”, nëse gjithmonë po them: “Unë jam, unë jam, unë jam.”

E dini historinë e Alexander Whyte-it në kishën “Free St. George”, kur një djalë i ri, në kontekstin e shërbesës së pashoqe të Alexander Whyte-it, mezi priste mundësinë që të predikonte në atë kishë. Ai e di që Alexander Whyte-i është i famshëm dhe i efektshëm si predikues, ama ka një dyshim që nuk e lë rehat, që ai, si djalosh i ri, sapo të dalë të predikojë, do të ketë mundësi t’ia kalojë në shkëlqim shërbesës së Alexander Whyte-it. Dhe se të gjithë do ta kuptojnë që personi për të cilin kanë pritur në të vërtetë, është ky djalosh i ri, të cilin nuk e mban vendi për ta shfrytëzuar mundësinë e tij të parë për të predikuar.

Kështu vazhdon historia. Erdhi momenti kur ai, me Biblën dhe shënimet e tij, iu ngjiti shkallares së foltores. Vendosi aty Biblën dhe shënimet, u tregoi tekstin që kishte zgjedhur, dhe filloi ta përcillte mesazhin. Tha një apo dy fjali, foli edhe pak, gjuha iu ngjiti në qiellzë, dhe e kapi paniku. “Ahhh...!” dhe më në fund ia doli ta mbyllte. Shpalli bekimin, mori gjërat e tij dhe zbriti nga ana tjetër. Një zotëri plak i cili ishte ulur në fund, u kthye nga shoku i tij dhe i tha: “Nëse ai djalosh do të ishte ngjitur ashtu si zbriti, nuk do të kishte zbritur ashtu si u ngjiti.”

“Thesar në enë prej balte”

“Ne nuk shpallim veten tonë.” Ne jemi një zë që thërret. Ne jemi një gisht që tregon. Ne jemi një dritë që shkëlqen. “Dhe ne e kemi këtë thesar në enë prej balte, që epërsia e pashoqe e kësaj fuqie të jetë e Perëndisë dhe jo prej nesh.”¹³ Kur të shkoj në qiell, një nga pyetjet që kam për Palin është kjo: “A po mendoje për Gedeonin kur e shkrove atë varg?”. Kam një dyshim që s’më lë rehat, që për atë po mendonte. Mendoni për atë grupin e shkartisur të Gedeonit: “Jo, janë ende shumë.” “Çfarë?” “Jo!” “Rralloje sërish grupin!” Ata që ulen në gjunjë, ata që e çojnë ujin me duar në gojë dhe gjithë hollësitë e tjera, pas së cilave fiksohen njerëzit kur përpiqen të ritregojnë historinë e Gideonit—këto realisht janë informacione të parëndësishme. Gjithë sa Perëndia po bën,

¹³ 2 e Korintasve 4:7.

është që po e zvogëlon grupin në një numër, i cili do të shfaqë në mënyrë të pakundërshtueshme faktin që fitorja është e Perëndisë.¹⁴ Perëndia do ta bëjë këtë në jetët tona, në çfarëdo mënyre që të zgjedhë. Mund t’ju tregoj mënyra se si ai e ka bërë këtë gjë në jetën time. Mund të jeni ulur dhe të thoni: “Atij mund t’i duhet ta bëjë edhe disa herë.” Me këtë bie dakord. Megjithatë, fakti është që ai ka lloj-lloj mënyrash për të na treguar se nëse Perëndia nuk e bën këtë, asgjë nuk do të ndodhë.

Ngeca sërish—mendoj se jua thashë këtë; më në fund do të kthehem edhe një herë në fillim, dhe atëherë e dini që është momenti që ta mbyll. Por më bëri përshtypje sërish, kur isha në zyrën e Billy Graham-it, në *The Cove*, kur kuptova që ai kishte atje vetëm një diplomë, atë që ishte lëshuar nga kolegji “Wheaton” (Wheaton College). Ai kishte vetëm një diplomë. Pastaj më dhanë një libër të jetës dhe shërbesës së Billy Graham-it. E pashë, dhe mendoj se i kanë dhënë njëzet e pesë doktoratura nga e gjithë bota. Në të gjitha ato raste, atij i është dashur të vishet si për diplomim dhe të kalojë ritualin, duke e ditur gjithë kohën që ai nuk e kishte fituar as edhe një të njënjë prej atyre doktoraturave. Perëndia kishte zgjedhur që të derdhte mbi të, gjithë këtë bekim dhe gjithë këtë vajosje.

Prandaj, le ta kujtojmë këtë gjë. Kur personaliteti ynë ka prirjen të ndërhyjë, atëherë, le të vendosim që të lartësojmë fort Krishtin! Nuk mund të tregoni dot njëkohësisht që ju jeni të shkëlqyer dhe që Jezusi është i mrekullueshëm.

“Ne ia rekomandojmë veten tonë ndërgjegjes së çdo njeriu”

Si përfundim duhet të them: “Ne ia rekomandojmë veten tonë ndërgjegjes së çdo njeriu.” A po më ndiqni se si po e bëj këtë? Ju thoni: “Nuk po bën një punë shumë të mirë.” Kjo është në rregull. Dua të jem inkurajim për ju. Dakord? Ne nuk ligështohemi. Nuk përdorim mashtrim. Nuk

¹⁴ Shih Gjyqtarët 7:1–7.

e shtrembërojmë Fjalën e Perëndisë. Nuk shpallim veten. “Ne ia rekomandojmë veten tonë ndërgjegjes së çdo njeriu.” Pali ishte ai të cilin e kishin akuzuar pa baza. Prandaj, ai thotë: “Tani, tregohuni të sinqertë; zbulojeni!”. Mbi çfarë baze e bën ai thirrjen e tij? “Duke e shpallur qartë të vërtetën.” “Duke shfaqur të vërtetën, ne ia rekomandojmë veten tonë ndërgjegjes së çdo njeriu.” Perëndia na ndihmoftë që, ndërsa kthehemi këtë fundjavë, ta shfaqim qartë të vërtetën!

Ne shpallim “Krishtin Jezus, Zotin”

Pastaj, vini re që ne shpallim Krishtin Jezus si Zot: “Ne nuk shpallim veten tonë, por” ne shpallim “Krishtin Jezus si Zot.” Bota jonë është e gatshme ta pranojë vargun Gjoni 14:6, me kusht që të mos e citojmë pjesën e fundit. Bashkësitë tona, miqtë dhe fqinjët tanë, ndërsa ne jetojmë një jetë ungjillëzuese, janë mjaft të gatshëm që ne të çohemi dhe të themi: “Jezusi tha: ‘Unë jam udha... e vërteta dhe jeta.’” Ajo të cilën kultura jonë bashkëkohore s’mund ta durojë dot, është përfundimi i vargut: “Askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje.” Një krishterim i papërcaktuar është i pranueshëm. Por krishterimi i përcaktuar nuk është popullor.

Çfarë po predikojmë? Ne po predikojmë Jezu Krishtin si Zot, “ndërsa veten tonë shërbëtorët tuaj për hir të Jezu Krishtit.” Në kontekstin e pluralizmit në të cilin jetojmë tani, kjo do t’i japë mprehtësi asaj që po ndodh. Në librin e tij *The Heralds of God*, James Stewart-i thotë se, kur apostujt predikuan, ndodhi një pushtim hyjnor.

Ata nuk po thoshin thjesht: “E dini çfarë? Ja një tregim historik”, por kishte një ndjesi në të cilën, kur ata predikonin, Perëndia ishte i pranishëm. Nëse citojmë sërish nga Stewart-i, ishte “një fllad i mbinatyrshëm, një fuqi e mistershme si ushtimi e një ere të fuqishme.”¹⁵ A nuk e dëshironi edhe ju këtë? A nuk e dëshironi këtë? Unë për vete e di që e dëshiroj. Ju e keni parasysh ndjesinë: “O Perëndi, duhet t’i shqyesh qiejt dhe të zbresësh!”.

¹⁵ James S. Stewart, *A Faith to Proclaim* (London: Hodder and Stoughton, 1953), 45.

Njerëzit më kanë pyetur për vajosjen e Perëndisë dhe për gjëra të tjera si kjo. Çfarëdo që të jetë, ne kemi nevojë për të! Çfarëdo që të jetë, ne e duam atë! Madje e duam me bollëk! Dua të lexoj gjithçka që kam mundësi në lidhje me të, pastaj dua të lexoj edhe më shumë, dhe dua t'i përgjyerohem Perëndisë për të. E kuptoj që Fryma e Perëndisë i është dhënë njeriut të Perëndisë, në mënyrë që Fjala e Perëndisë të shpallet për dobinë e popullit të Tij. Nëse kemi vetëm Fjalën pa Frymën, njerëzit do të thahen. Nëse kemi vetëm Frymën pa Fjalën, njerëzit do të krekosen. Por nëse kemi edhe Frymën edhe Fjalën, njerëzit do të ndërtohen. Ne nuk mund ta predikojmë dot Jezusin si Zot dhe ta bëjmë këtë gjë të mërzitshme dhe pa gjallëri. Predikimi i Jezusit ishte i gjallë, ishte me autoritet, ishte i organizuar mirë, ishte praktik, ishte interesant dhe ishte i vërtetë.

Shembuj përmbyllës

Kjo ishte gjithçka që doja të ndaja me ju nga kjo pjesë. Dua që ta përmbyll dhe t'ju jap disa shembuj që kam dashur t'ju siguroj. Hidhni sërisht një sy vargut 16: “Prandaj nuk ligështohemi; por, edhe pse njeriu ynë i jashtëm prishet, ai i brendshëm përtërihet nga dita në ditë.” Dua ta mbyll duke ju ofruar disa këshilla nga tre prej heronjve të mi.

Kjo është shkëputur nga faqja 747—juve që ju pëlqejnë avionët, duhet ta mbani mend këtë—në vëllimin e dytë të *Martyn Lloyd-Jones-it*, fotoja e tij e këndshme zbukuron edhe kapakun e këtij libri. Nëse nuk i keni lexuar kurrë dy vëllimet e jetës së Lloyd-Jones-it, atëherë nuk e keni mbaruar shkollimin tuaj. Këto dy vëllime mund t'i blini në librarinë tonë me 20 përqind ulje. Tani jemi në fund të jetës së Lloyd-Jones-it, gjë e cila është inkurajim për ju që parapëlqeni të lexoni fundin e historisë para se ta nisni atë, le të jetë kjo një ndihmë për ju.

Fjalët e tij të fundit me zë ishin ato që ai i tha doktorit të tij, Grant Williams-it, i cili e vizitoi më 24 shkurt. Z. Williams donte t'i jepte disa antibiotikë. Lloyd-Jones-i tundi kokën për të thënë se nuk ishte dakord. “E po”, i tha doktori, “kur të vijë koha e Zotit, edhe pse të

mbush plot me antibiotikë, nuk ka për të pasur rëndësi.” Pacienti sërish mohoi me kokë. “Dua të të bëj të ndihesh rehat, më rehat”, i tha Williams-i, “më pikon në zemër të të shoh... kështu ‘të lodhur... të tretur dhe të trishtuar.’”

Ai po i citonte himnin e Bonar-it,¹⁶ të cilin e dinte që Lloyd-Jones-i do ta njihte. Prandaj, ai i tha:

“Më pikon në zemër të të shoh... kështu [të ulur] ‘të lodhur... të tretur dhe të trishtuar.’”

Kjo ishte e tepërt për [Martyn Lloyd-Jones-in]. “Jo të trishtuar!”, i tha ai. “Jo të trishtuar!” E vërteta ishte që ai besonte se puna e vdekjes ishte kryer dhe se ishte gati të shkonte. “Mbrëmë”, i shkroi Grant Williams-i doktorit lokal [të Martyn Lloyd-Jones-it] më 25 shkurt, “ai nuk pranoi t’i pinte antibiotikët, mezi fliste dhe mendoj se do të vdesë shumë shpejt. Mendoj se është shumë i kthjellët dhe e di shumë qartë se çfarë do të bëjë.”

[Dhe] kur nuk mund të fliste më, [vajza e tij] Elizabeta [ulur] pranë tij, ai e drejtoi qartazi te fjalët e 2 e Korintasve 4:16-18 që thonë: “Prandaj nuk ligështohemi; por, edhe pse njeriu ynë i jashtëm prishet, ai i brendshëm përtërihet nga dita në ditë. Sepse shtrëngimi ynë i lehtë i tashëm, prodhon për ne, një peshë të përjetshme të pamasë e të pashoqe të lavdisë...”

Elizabeta thotë: “Kur e pyeta nëse ky ishte përjetimi i tij tani, ai pohoi me forcë, duke tundur kokën.”¹⁷

Ky ishte Lloyd-Jones-i.

Pastaj kemi Calvin-in:

Sa më të vendosur që të jenë njerëzit në përbuzjen e mësimit të Krishtit, aq më të zellshëm duhet të jenë shërbyesit e krishterë për ta theksuar atë dhe aq më të palodhura duhet të jenë përpjekjet e tyre për ta ruajtur të plotë, madje më tepër se kaq, t’i shpartallojnë sulmet e Satanit përmes zellit të tyre.¹⁸

¹⁶ Horatius Bonar, “I Heard the Voice of Jesus Say” (1846).

¹⁷ Iain H. Murray, *David Martyn Lloyd-Jones*, vëllimi 2, *The Fight of Faith: 1939–1981* (Edinburgh: Banner of Truth, 1990), 746–47.

¹⁸ John Calvin, *The Second Epistle of Paul the Apostle to the Corinthians and the Epistles to Timothy, Titus and Philemon*, përkthyer nga T. A. Smail-i, redaktuar nga David W. Torrance dhe Thomas F. Torrance (1964; ribotuar në Grand Rapids: Eerdmans, 1996), 334.

Me fjalë të tjera, shumë të dashur, sa më të vështira të jenë kohërat, sa më shurdhër të jenë njerëzit, aq më e qartë dhe aq më *tepër* bindëse duhet të jetë shpallja jonë. Në vend që të kthehemi pas dhe t'i dorëzohemi frymës së epokës, duke thënë: “E di çfarë? Njerëzit duket se janë të shurdhër, ata duken se janë shumë të topitur. Monologu nuk funksionon. Prandaj, le të bëjmë gjithë këto gjërat e tjera.” “Jo, jo, jo”, themi ne: “nuk do ta bëjmë aspak atë gjë.” Ne do të kapemi edhe më fort pas qasjes antike të shpalljes së Biblës në fuqinë e Frymës, duke besuar se ky është mjeti përmes të cilit Perëndia u jep jetë të vdekurve.

Pra, keni shembullin e Lloyd-Jones-it, keni shembullin e Calvin-it, dhe kush do të jetë heroimi im i fundit? Dwight L. Moody. Dwight L. Moody. Për ju që jeni kalvinistë në palcë, kjo është e vështirë! Ai është ende një nga heronjtë e mi të mëdhenj. Kur Moody shkoi në Skoci më 21 nëntor 1873, shkoi me frikë dhe me dridhje, pasi nëse citojmë nga një prej biografëve të tij, ai thotë: “Skocezët shquhen për njohjen e teologjisë së tyre.” Sigurisht që të tillë ishin në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë.

Ai që dëshiron ta ndërtojë në besim një bashkësi [skocezësh], duhet të vijë tek ata me vajin e kulluar të shenjtërores; ta derdhë atë... me enët e duhura të një forme tradicionale. Ai duhet të jetë burrë që ka arritur gjëra të mëdha në arsimim; ai duhet të jetë i vulosur nga ndonjë universitet; dhe mbi të gjitha, ai duhet të vijë me rekomandimin e ndonjë grupi të shquar pastorësh.

Tani dëgjoni:

Të gjitha këto gjëra i mungonin z. Moody. Nëse do të kishte një predikues në gjithë botën, i cili do të refuzohej në Skoci, pa llogaritur fuqinë e Perëndisë, që e shoqëronte, ky burrë do të ishte [Dwight] L. Moody.¹⁹

Me fjalë të tjera, ai nuk kishte *asnjë* shans që të kishte ndikim në Skoci!

¹⁹ W. H. Daniels, *D. L. Moody and His Work* (London: Hodder and Stoughton, 1875), 266–67.

Kur vazhdoni ta lexoni biografinë, thuhet: “Takimi i lamtumirës së... Moody-t dhe Sankey-t... u mbajt në kodrat e Fronit të Arturit (Arthur’s Seat).”²⁰ Froni i Arturit është kodra pas pallatit “Holyrood” (Holyrood Palace) në fund të Miljes Mbretërore (Royal Mile), të cilën, nëse nuk keni qenë atje, e keni parë në filmin *Karrocat e Zjarra*, ku Eric Liddell-i ecën me motrën e tij Jennyn, dhe ajo e qorton për faktin që ai nuk po i kushtohet me gjithë zemër misionit. Kjo është një fushë e bukur me bar në atë zonë të Edinburgut. “Takimi i lamtumirës së Moody-t dhe Sankey-t u mbajt në kodrat e Fronit të Arturit”—pse?—”nuk kishte asnjë ndërtesë që mund t’a nxinte gjithë atë bashkësi njerëzish. Nga froni historik i krishterimit, në të cilin kishin hyrë me frikë dhe dridhje, ata u larguan me gëzim në zemrat e tyre.”²¹

Pse? Sepse Moody ishte një burrë shumë i veçantë? Jo. Por për arsye se ungjilli është një histori kaq e lavdishme. Na bëftë Perëndia burra të ungjillit!

Le të lutemi së bashku:

Përpara fronit të Zotit lart,
Kam një Kryeprift që më do fort,
Një Avokat të përsosur kam
Që sot jeton, më ndërmjetëson

Kur djalli do t’me dëshpërojë
Dhe më tregon çdo gabim
Lart shoh, Atë lart e shikoj
Që i dha fund mëkatit tim.
Se Shpëtimtari pa mëkat vdiq
Shpirti im [fajtor] i drejtë u bë
Se Perëndia i drejtë u kënaq
Të shoh Atë dhe mua të më falë.²²

Jemi të mahnitur para teje, o Perëndi i hirshëm, që nga të gjitha vendet ku mund të ishim tani, ti i ke drejtuar hapat tanë në mënyrë që të na japësh privilegjin e të qenët në miqësinë e njëri-

²⁰ Daniels, 291.

²¹ Daniels, 291 (parafrazim).

²² Charitie L. Bancroft, “Before the Throne of God Above” (1863).

tjetrit. Madje shumë më tepër se kaq, na ke dhënë praninë e përhershme të Frymës së Perëndisë, në faktin që kemi ardhur bashkë për të lartësuar Krishtin dhe Fjalën e tij, si dhe në dëshirën tonë për ta nxitur dhe për ta inkurajuar njëri-tjetrin, aq më tepër që e shohim se dita e kthimit të Krishtit po afrohet.²³

Ne lutemi për njëri-tjetrin, dhe duam ta dorëzojmë veten tonë në kujdesin dhe ruajtjen tënde. Lutemi që, mes shumë fjalëve, të mos na humbasin nga sytë gjërat thelbësore. Ne lutemi që të tërhiqemi sërish te Krishti dhe te Fjala e tij; që ti të na mbushësh sërish me Frymën tënde dhe të na dërgosh në vendet ku na ke caktuar me një zell të ripërtërirë, me një përlësi të vërtetë, me një dëshirë që ti të vish dhe të bësh gjëra të cilat mund të shpjegohen vetëm sepse ti je shfaqur me fuqinë dhe pushtetin tënd. Na shpëto nga bërja e planeve të vogla, sepse ato nuk janë në gjendje që t'i ndezin ambiciet e njerëzve. Na jep një soditje të asaj bashkësie të cilën askush nuk mund ta numërojë dot.²⁴ Na ndihmo që t'i jetojmë ditët tona duke bërë pjesën tonë, cilado qoftë ajo, duke u përpjekur që të shohim burra dhe gra që nuk besojnë, të bëhen ndjekës të përkushtuar të Jezu Krishtit.

Dhe atij që mund t'ju ruajë nga çdo rrëzim dhe t'ju vërë të paqortueshëm dhe me ngazëllim para lavdisë së tij, të vetmit Perëndi të urtë, Shpëtimtarit tonë, i qoftë lavdi dhe madhështi, sundim dhe pushtet, edhe tani, edhe në përjetësi. Amen.

²³ Shih Hebrenjve 10:25.

²⁴ Shih Zbulesa 7:9.